

VENDIM
Nr. 819, datë 28.12.2023

**PËR SHPËRBLIMIN E KATEGORISË SË PERSONAVE QË PËRFITOJNË
PENSION INVALIDITETI DHE PENSION FAMILJAR, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, të personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për vitin 2023.

2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona të cilëve iu lind e drejta për përfitimin e pensionit deri në datën 31.12.2023, përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë ta marrin vetëm një herë këtë shpërblim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 560 473 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë), e ndarë në 556 025 000 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëzet e pesë mijë) lekë për shpërblimin dhe 4 448 000 (katër milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit. Efektet financiare përballohen nga “Fondi i kontingjencës”, i miratuar në buxhetin e vitit 2023 dhe buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.

4. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2023 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2023, ato do të paguhen gjatë vitit 2024. Shpërblimi i patërhequr parashkruhet pas datës 31.12.2024.

5. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore e Posta Shqiptare sh.a. dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura, që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi, të cilat autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama